


Transparenca e ministrive përmes faqeve zyrtare



Hyrje

Ky punim i shkurtër vlerëson transparencën e ministrive në atë se sa publikojnë të dhëna të nevojshme për qytetarët dhe bizneset (në kuptimin person fizik dhe juridik) përmes faqeve të tyre zyrtare. Për këtë qëllim, janë marrë nëntë tregues përmes të cilëve janë vlerësuar faqet zyrtare të 14 ministrive¹. Këta tregues janë të përcaktuar me akt nënligjor² për ueb faqet e institucioneve publike i bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike³. Edhe pse udhëzimi administrativ përfshinë të gjitha institucionet publike, në fokus të këtij punimi janë vetëm ministrinë, pra pa përfshirë Zyrën e Kryeministrit dhe as agjencitë ekzekutive në kuadër të tyre.

Nëntë treguesit përmes të cilëve matet transparenca e ministrive në publikimin e informatave për qytetarët, përmes faqeve zyrtare janë:



- 1 Detyrat dhe përgjegjësitë e ministrisë;
- 2 Struktura organizative e ministrisë;
- 3 Emrat dhe kontaktet e drejtorëve të departamenteve dhe divizioneve;
- 4 Kontakti i ministrisë (adresa postare, emaili dhe numri i telefonit);
- 5 Lista e shërbimeve administrative që ofron ministria për qytetarë dhe biznese;
- 6 Buxheti vjetor i ndarë vetëm për ministrinë dhe klasifikuar sipas kategorive;
- 7 Raporte periodike mbi shpenzimet e ministrisë;
- 8 Raporti vjetor (i performancës) i ministrisë për vitin paraprak;
- 9 Plani vjetor (i performancës) i ministrisë për vitin aktual.

1 Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) nuk ka faqe zyrtare aktive andaj nuk është pjesë e vlerësimit në këtë punim.

2 Ministria e Administratës Publike, 2015, Udhëzimi Administrativ (MAP) nr. 01/2015 për Ueb Faqet e Institucioneve Publike, (qasur për herë të fundit 06.10.2022). Mund të gjendet në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11007>

3 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2019, Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, (qasur për herë të fundit 05.10.2022). Mund të gjendet në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20505>

Për të vlerësuar nëse treguesi është i përmbushur nga ministria, janë përdorur dy shenja:

-  do të thotë se treguesi është i përmbushur
-  do të thotë se treguesi nuk është i përmbushur

Të 14 ministrat tjerë paraqiten me shkurtesa nëpër tabelat e treguesve (lista e shkurtesave në fillim të këtij punimi tregon se për cilën ministri bëhet fjalë në vlerësim).

Vlerësimi i përmbushjes së treguesve është bërë përmes hulumtimit të faqeve zyrtare të 14 ministrave për informatat sipas nëntë treguesve, në mes të datave 7 - 10, tetor 2022.

Shkurtesat e përdorura për ministrat

MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MD	Ministria e Drejtësisë
MM	Ministria e Mbrojtjes
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSh	Ministria e Shëndetësisë
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MBPZhr	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
ME	Ministria e Ekonomisë
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MZhr	Ministria e Zhvillimit Rajonal

Treguesit dhe përmbushja e tyre nga ministrinë sipas vlerësimit të faqeve zyrtare

1 Detyrat dhe përgjegjësitë e ministrisë

Detyrat dhe përgjegjësitë e ministrive është me rëndësi të jenë të publikuara në faqet zyrtare për të treguar misionin dhe fushat e përgjegjësisë së tyre. Ekzistimi i fushave të përgjegjësisë të ministrive në akt nënligjor⁴ nuk është arsye për mos publikimin e tyre në faqe zyrtare.

Treguesi 1	Ministrinë													
Detyrat dhe përgjegjësitë e institucionit	MPJD	MFPT	MD	MM	MPB	MSh	MASHTI	MKRS	MAPL	MMPHI	MBPZHR	ME	MINT	MZHR

Siç shihet nga tabela, tetë (8) nga 14 ministri nuk e kanë të përshkruar në faqen kryesore të tyre se cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë e ministrisë.

2 Struktura organizative e ministrisë

Struktura organizative e ministrisë ka të bëjë me ndarjen e ministrisë në departamente dhe njësi vartëse, apo organogrami i ministrisë. Edhe pse ky është një tregues mjaft teknik, megjithatë vlerësohet i nevojshëm për t'i treguar publikut ndërtimin dhe strukturën e ministrisë përkatëse.

Treguesi 2	Ministrinë													
Struktura organizative e ministrisë	MPJD	MFPT	MD	MM	MPB	MSh	MASHTI	MKRS	MAPL	MMPHI	MBPZHR	ME	MINT	MZHR

Për dallim nga treguesi i parë, numër më i madh i ministrive e kanë të përmbushur këtë tregues. Siç shihet nga tabela, 11 ministri e kanë të publikuar strukturën organizative në faqen e tyre zyrtare, përderisa tri (3) të tjera jo.

3 Emrat dhe kontaktet e udhëheqësve të departamenteve dhe divizioneve

Publikimi i emrave të drejtorëve të departamenteve dhe udhëheqësve të divizioneve që realisht janë pjesa kryesore e ministrisë, duhet të jenë publik për qytetarët për të kuptuar se “kush është kush” në ministri. Po ashtu, publikimi i numrave kontaktues dhe e-mail adresave të udhëheqësve

⁴ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2021, Rregullore nr. 01/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, (qasur për herë të fundit 07.10.2022). Mund të gjendet në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=39317>

të departamenteve apo divizioneve të ministrive i jep mundësi qytetarëve, shoqërisë civile, organizatave hulumtuese dhe palëve tjera të interesuara për t'i kontaktuar direkt udhëheqësit e departamenteve dhe divizioneve që në fakt janë ofruesit e shërbimeve për qytetarët.

Treguesi 3	Ministritë													
Emrat dhe kontaktet e udhëheqësve të dep / div	MPJD	MFPT	MD	MM	MPB	MSH	MASHTI	MKRS	MAPL	MMPHI	MBPZHR	ME	MINT	MZHR
	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✗	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓

Ky tregues është përmbushur nga 13 ministri të cilat kanë të publikuara emrat dhe kontaktet (numër telefoni dhe e-mail) të udhëheqësve të departamenteve dhe divizioneve. Ministria e cila nuk e përmbush këtë tregues është MASHTI⁵ që ka të publikuar emrin dhe kontaktin vetëm të udhëheqësit të divizionit për komunikim me publikun. Në grupin e 13 ministrive që kanë përmbushur këtë tregues, MD nuk ka të publikuar emrin dhe informatat e kontaktit për udhëheqësin e departamentit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar. MMPHI nuk ka të publikuar të njëjtat të dhëna për udhëheqësin e departamentit të inspektoratit, derisa MSH nuk ka të publikuar informatat për dy nga katër departamente. Megjithatë, meqenëse këto ministri kanë të publikuara kontaktet për shumicën e departamenteve dhe divizioneve tjera, ky tregues është vlerësuar si i përmbushur.

4 Kontakti i ministrisë (adresa postare, e-maili dhe numri i telefonit)

Ky tregues përbëhet nga tre elementë: adresa postare e ministrisë, e-maili i përgjithshëm i ministrisë (jo i ndonjë personi specifik) dhe numri i telefonit për ministrinë. Këto tre elemente janë me rëndësi nëse pala (qytetari dhe biznesi pavarësisht a është brenda apo jashtë vendit) mund të kërkojë të kontaktojë ministrinë. Nëse pala ka takim në ministrinë përkatëse, duhet të dihet fillimisht adresa e ministrisë, nëse pala ka një kërkesë/njoftim për ministrinë si tërësi, duhet të dihet e-maili i ministrisë dhe njëjtë edhe numri i telefonit.

Treguesi 4	Ministritë													
Kontakti i ministrisë (adresa, e-maili, telefoni)	MPJD	MFPT	MD	MM	MPB	MSH	MASHTI	MKRS	MAPL	MMPHI	MBPZHR	ME	MINT	MZHR
	✓	✓	✓	✗	✓	✓	✗	✓	✓	✓	✓	✗	✓	✓

Siç vërehet nga tabela, tre (3) nga 14 ministri nuk kanë informata të plota për kontaktin e ministrisë, d.m.th. tre elementët e cekur më sipër. Për shembull, MASHTI ka të publikuar vetëm adresën e ministrisë por jo edhe e-mailin dhe numrin e telefonit. Nëse ministria nuk ka të publikuar dy nga tre elementë nuk mund të merret që ka plotësuar treguesin, mirëpo vetëm nëse një nga tre elemente nuk është i publikuar, është marrë si plotësim i kushtit të treguesit.

5 Ministria e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, Divizioni për Komunikim me Publikun, (qasur për herë të fundit 10.10.2022). Mund të gjendet në <https://masht.rks-gov.net/divizioni-per-komunikim-publik/>

5 Lista e shërbimeve administrative që ofron ministria për qytetarë dhe biznese

Me shërbime administrative kuptohet dhënia e lejeve dhe licencave për biznese, p.sh. leja për punë, licenca ndaj një biznesi për plotësim të kushteve higjienike dhe sanitare që lëshohen nga MINT dhe MSh, pastaj certifikata dhe dokumente të gjendjes civile që lëshohen nga Ministria e Punëve të Brendshme, etj. Pra, lista e shërbimeve administrative që ofron ministria për qytetarët dhe bizneset duhet të jetë e publikuar si kategori e veçantë në faqet e tyre zyrtare. Kjo shërben si mjet për qytetarët në marrjen më të lehtë të informacioneve si dhe në orientimin e tyre se në cilën ministri dhe cila është procedura deri në marrjen e shërbimit të nevojshëm.

Treguesi 5	Ministritë													
Lista e shërbimeve që ofron ministria	MPJD	MFPT	MD	MM	MPB	MSh	MAShTI	MKRS	MAPL	MMPHI	MBPZHR	ME	MINT	MZHR
	✗	✗	✗	N/A	✓	✗	✗	✗	N/A	✓	✓	✗	✗	✗

Nga 14 ministri përjashtohen nga vlerësimi në këtë tregues Ministria e Mbrojtjes (MM) dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) pasi nuk ofrojnë shërbime administrative për qytetarë dhe biznese për shkak të natyrës së punës që kanë. Sa i përket 12 ministrive tjera, tri (3) prej tyre e përmbushin këtë kriter, kurse nëntë (9) tjera nuk i kanë të publikuara listën me shërbime administrative që i ofrojnë për qytetarë dhe biznese.

6 Buxheti vjetor i ministrisë dhe i klasifikuar sipas kategorive

Ky tregues nënkupton publikimin e buxhetit vetëm për ministrinë përkatëse si organizatë buxhetore, në faqen zyrtare të saj dhe të ndarë sipas kategorive kryesore ekonomike. Ligji vjetor mbi ndarjet buxhetore është i publikuar në faqe zyrtare të MFPT-së⁶ mirëpo kjo nuk është e mjaftueshme për këtë tregues sepse nuk është e lehtë për qytetarët së pari të gjejnë ligjin, të lexojnë tabelat ku janë të gjitha organizatat buxhetore e pastaj të gjejnë ministrinë për të cilën kanë interesim. Pra, ndarjen e buxhetit për ministrinë duhet ta vendosë secila ministri në faqen e saj zyrtare, për të rritur nivelin e llogaridhënies dhe transparencës ndaj qytetarëve.

Treguesi 6	Ministritë													
Buxheti vjetor i ministrisë dhe i klasifikuar sipas kategorive	MPJD	MFPT	MD	MM	MPB	MSh	MAShTI	MKRS	MAPL	MMPHI	MBPZHR	ME	MINT	MZHR
	✗	✓	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✓	✗	✗	✗	✗	✓

Siç shihet në tabelë, 11 ministri nuk e kanë të publikuar buxhetin vjetor derisa tri (3) prej tyre e kanë të publikuar atë të ndarë sipas kategorive.

⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2021, Ligji nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2022, (qasur për herë të fundit 05.10.2022). Mund të gjendet në <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1F77FA35-E121-43D3-9683-791B0ADE3337.pdf>

7 Raporte periodike mbi shpenzimet e ministrisë

Ky tregues ka të bëjë me publikimin e shpenzimeve në baza periodike, qoftë ato javore, mujore, tre mujore apo edhe gjashtëmujore të ministrisë. Mirëpo, shpenzimet duhet të jenë të publikuara jo vetëm sipas katër kategorive kryesore ekonomike, por të ndara sipas shpenzimeve reale, p.sh. sa është shpenzuar për karburante për një muaj në kuadër të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, sa është shpenzuar për telefon nga e njëjta kategori, sa është shpenzuar për investime kapitale dhe të tjera. Kjo e mundëson një llogaridhënie dhe transparencë më të mirë ndaj takspaguesve dhe qytetarëve në përgjithësi.

Treguesi 7	Ministritë													
Raporte periodike mbi shpenzimet e ministrisë	MPJD	MFPT	MD	MM	MPB	MSh	MAShTI	MKRS	MAPL	MMPHI	MBPZHR	ME	MINT	MZHR
	✗	✓	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✓	✗	✗	✗	✗	✓

Sikurse në rastin e treguesit gjashtë më lartë, edhe në treguesin shtatë vetëm tri (3) nga 14 ministri kanë të publikuar shpenzimet e tyre (MFPT, MAPL dhe MZHR).

8 Raporti vjetor (i performancës) i ministrisë për vitin paraprak

Raporti vjetor i ministrisë për vitin paraprak ka të bëjë me raportimin e ministrisë mbi të arriturat dhe punën për vitin e kaluar. Raporti vjetor nuk nënkupton listë të aktiviteteve por shpjegim nëse aktivitetet kanë ndikuar në arritjen e objektivave dhe rezultateve të ministrisë. Idealisht, ministritë duhet të kenë plane vjetore (të performancës) mbi realizimin e të cilave duhet të raportojnë përmes raporteve vjetore (të performancës). Pra, puna e ministrive përgjatë një viti duhet të prezantohet para publikut përmes raporteve vjetore për arritjen e objektivave sipas aktiviteteve të kryera. Kjo shërben si mjet për vlerësimin e përbushjes së objektivave brenda vitit, si dhe informon publikun për progresin e arritur në drejtime të caktuara si rezultat i punës së ministrisë.

Treguesi 8	Ministritë													
Raporti vjetor për vitin paraprak	MPJD	MFPT	MD	MM	MPB	MSh	MAShTI	MKRS	MAPL	MMPHI	MBPZHR	ME	MINT	MZHR
	✗	✗	✗	✗	✓	✗	✗	✗	✓	✗	✗	✗	✗	✓

Nga 14 ministri në këtë vlerësim, vetëm tri (3) ministri e përbushin këtë tregues (MPB, MAPL dhe MZHR).

9 Plani vjetor (i performancës) i ministrisë për vitin aktual


Plani vjetor për vitin aktual përcakton detyrat e ministrisë si tërësi dhe departamenteve e njësisve tjera sipas objektivave të përcaktuara në kuadër të objektivave strategjike të Qeverisë. Pra, plani vjetor i ministrisë (ministrive) është një zbatim i planit vjetor të Qeverisë në objektiva strategjike dhe specifike të ministrisë. Pastaj, agjencitë/departamentet bëjnë planet e tyre në kuadër të planit vjetor apo objektivave vjetore të ministrisë. Kjo mundëson një rrjedhë (kaskadë) të objektivave nga lartë poshtë: qeveri – ministri – agjenci – departament. Planet vjetore të punës duhet të publikohen në fillim të vitit, kjo me qëllim informimin e publikut për punën që do ta bëjë ministria brenda një viti dhe agjendën që e ka të përcaktuar.

Treguesi 9	Ministritë													
	MPJD	MFPT	MD	MM	MPB	MSh	MASHTi	MKRS	MAPL	MMPHI	MBPZhr	ME	MINT	MZHR
Plani vjetor për vitin aktual	✗	✗	✗	✗	✓	✗	✗	✗	✓	✗	✗	✗	✗	✗

Siç vërehet nga tabela, vetëm dy (2) nga 14 ministri e kanë përmbushur këtë tregues për vitin 2022, konkretisht MPB dhe MAPL kurse 12 ministri të tjera nuk kanë plane vjetore 2022.

Në aspektin se sa nga nëntë tregues ka përmbushur secila ministri, grafi në vazhdim paraqet këtë aspekt. Për shembull, nëse ministria përkatëse ka publikuar të gjitha dokumentet sipas nëntë treguesve, atëherë ka nëntë pikë, nëse ka publikuar tetë prej tyre, ka tetë pikë e kështu me radhë.

FIGURA 1: Përmbushja e përgjithshme e treguesve nga ministrinë



PËRFUNDIME

Nga gjithsej nëntë treguesit, ai që më së shumti është përmbushur nga ministrinë është treguesi mbi strukturën organizative të ministrisë dhe treguesi mbi publikimin e kontakteve të departamenteve dhe divizioneve. Treguesi katër (kontakti i ministrisë) është përmbushur aktualisht nga 10 prej 14 ministrive. Treguesi më së paku i përmbushur shprehur në numër të ministrive që e kanë përmbushur aktualisht, është treguesi nëntë apo plani vjetor (i performancës) i ministrisë, ku vetëm dy nga 14 ministri e kanë të publikuar atë. Pak më lartë janë të vlerësuar treguesit pesë, gjashtë, shtatë dhe tetë ku realisht vetëm nga tre prej 14 ministrive e kanë përmbushur atë.

Sa i përket publikimit të informacioneve që lidhen me planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit, treguesit gjashtë dhe shtatë janë njëjtë të përmbushur shprehur në numër të ministrive që e kanë përmbushur atë. Për shembull, të dy treguesit nuk janë përmbushur nga 11 ministri nga 14 në total. Po ashtu, vlen të ceket se të njëjtat ministri që nuk e kanë përmbushur treguesin gjashtë mbi publikimin e buxhetit vjetor, të njëjtat nuk e kanë përmbushur treguesin shtatë mbi publikimin e shpenzimeve periodike të ministrisë.

REKOMANDIME

- Secila ministri duhet të caktojë një person përgjegjës për të përditësuar dhe mirëmbajtur me shënime faqen zyrtare të ministrisë përkatëse, në bashkëpunim me Agjencinë për Shoqërinë e Informacionit (ASHI) në kuadër të MPB-së;
- Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP), sipas mandatit dhënë me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, duhet të komunikojë me zyrtarët përgjegjës në ministri për të mësuar se ku janë problemet dhe arsyt e mos publikimit të të dhënave sipas nëntë treguesve në këtë punim dhe udhëzimit administrativ për ueb faqet e institucioneve publike;
- Ministrinë duhet të publikojnë të dhënat sipas nëntë treguesve sepse janë kriteret minimale të transparencës dhe llogaridhënies ndaj publikut;
- Ministria për Komunitete dhe Kthim, në bashkëpunim në radhë të parë me ASHI duhet të kthejë në funksion faqen zyrtare të ministrisë dhe të njëjtën ta hostojë në Qendrën Shtetërore të të Dhënave të Republikës së Kosovës.

